



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 13.11.2023

Nr: 190

Ora: 11:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 35, DATË 2.11.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 13.11.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES:	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
OBJEKT:	Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Zerina Bruçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Kulturës
BAZË LIGJORE:	Nenet 19 pika 1 shkronja “c” dhe 21 pika 1 shkronja “dh” të K.Zgjedhor

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë denoncim për shkelje administrative nga ana e znj. Elva Margariti, Ministër i Kulturës dhe z. Erion Veliaj Kryetar për Bashkinë Tiranë, nëpërmjet së cilit pretendohet se ka patur shkelje të nenit 92 të K.Zgjedhor që rregullon veprimtarinë e institucioneve publike në fushatë, më konkretisht në fushatën për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.
2. Denoncimi me nr. 409 ID, është depozituar shkresërisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 4896 prot., datë 10.5.2023, ndaj znj. Elva Margariti Ministër i Kulturës dhe z. Erion Veliaj Kryetar i Bashkisë Tiranë, për 1 (një) veprimtari publike. Në rastin e denoncimit nr. 409 ID, në kundërshtim me nenin 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor, Ministri i Kulturës dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, kanë zhvilluar një takim në mjediset e hollit të Teatrit të Operas dhe Baletit me artistë të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe drejtues të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar Eksperimental dhe në varësi të bashkisë Tiranë si drejtues të Teatrit të Metropolit, Shtëpia Studio Kadare, Galeria e Artit Tiranë etj...
3. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ, në përfundim të të cilit ka arritur në konkluzionin se natyra e aktivitetit të kryer për denoncimin regjistruar me nr. 409 ID, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportimin në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të dedikuar për këtë qëllim. Institucioni organizator duhet të mbajë përgjegjësi në lidhje me mosraportimin e veprimtarisë publike. Gjithashtu Komisioneri në vendimin e tij arsyeton se veprimtaria publike, është zhvilluar në ambjentet e hollit të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, dhe është veprimtari publike, që për shkak të natyrës, fjalimit dhe pjesëmarrjes, provohet që është veprimtari publike e organizuar nga ana e Ministrisë së Kulturës.
4. Komisioneri arrin në konkluzionin se përgjegjësia për raportimin e veprimtarisë publike i atribuohet personit përgjegjës pranë Ministrisë së Kulturës si organizatore e këtij takimi, pasi evidentohen qartazi fakte dhe rrethana që përfshihen në dispozitat e përcaktuara në nenin 92

të Kodit Zgjedhor si dhe në vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

5. Me anë të vendimit nr. 812, datë 20.10.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur t'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, gjobë në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për znj. Zerina Bruci person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë së Kulturës.
6. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë të regjistruar me nr. 7402 prot., datë 2.11.2023, duke kërkuar vendosjen e masës administrative me gjobë mbështetur në nenin 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor.
7. KQZ caktoi me short anëtarin e KAS-it z. Ledio Braho, relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 35, datë 2.11.2023 të Komisionerit. KAS në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më datë 13.11.2023, ora 11:00.
8. Seanca e datës 13.11.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Pavarësisht kërkesës objekt i këtij shqyrtimi administrativ, për këtë proces janë njoftuar të gjitha palët që kanë qenë pjesë e hetimit administrativ nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në seancën e shqyrtimit u paraqitën znj. Xhulia Xhaferi, në cilësinë e personit të kontaktit në Ministrinë e Kulturës si dhe znj. Fabiola Islami me detyrë juriste pranë Ministrisë së Kulturës. Gjithashtu e pranishme në seancën e shqyrtimit të kësaj kërkesë ishte dhe znj. Gjyljana Bakalli, me funksion Juriste pranë Organizatës "Drejtësia Sociale.
9. Përfaqësueset e Ministrisë së Kulturës gjatë pretendimeve të tyre të depozituara edhe me shkrim nëpërmjet shkresës nr. 5739.4 prot., datë 13.11.2023 parashtruan se, Aktiviteti "Të flasim për Artin", është zhvilluar më datë 3.5.2023, referuar fotove të publikuara në rrjetin social "Instagram", të Ministrisë së Kulturës por edhe komunikimit me e-mail të datës 7.11.2023, përcjellë nga Kabineti i Ministres. Referuar e-mailit të Kabinetit të Ministres bëhet me dije se institucioni organizator i këtij aktiviteti është bashkia Tiranë dhe znj. Elva Margariti,

Ministër i Kulturës ka marrë pjesë në këtë aktivitet si e ftuar nga kryetari i bashkisë. Për të provuar këtë argument, ato vendosën në dispozicion të KAS ftesën e kandidatit për kryetar të bashkisë Tiranë për të marrë pjesë në këtë aktivitet.

10. Përfaqësuesja e Organizatës “Drejtësia Sociale”, gjatë seancës së shqyrtimit të kësaj kërkesë parashtrori se, kemi të bëjmë me një aktivitet politik dhe jo kulturor. Aktiviteti është zhvilluar nga ana e Bashkisë Tiranë. Gjithashtu në cilësinë e provës kërkoi të administrohet ftesa si dhe korrespondenca me e-mail ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Tiranë, për aktivitetin e zhvilluar.

11. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi këto prova shkresore:

- Kërkesën nr. 35, datë 2.11.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Vendimin nr. 812, datë 20.10.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit regjistruar me nr. 409 ID, të Organizatës “Drejtësia Sociale”, ndaj personave përgjegjës në Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor, për mosraportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023”;
- Denoncimin nr. 409 ID, administruar nëpërmjet shkresës nr. 4896 prot., datë 10.05.2023 si dhe foto/prova bashkëlidhur;
- Njoftimet/komunikimi nëpërmjet postës elektronike për zhvillimin e senacave dhe kërkesa për informacion me personat objekt hetimi administrativ;
- Shkresën nr. 5739/4 prot., datë 13.11.2023, me lëndë “Parashtrime”, depozituar nga Ministria e Kulturës, gjatë seancës së shqyrtimit të kërkesës.
- Ftesa e z. Erion Veliaj “Të flasim për Artin”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton se:

1. Organizata “Drejtësia Sociale” ka depozituar pranë Komisionerit denoncim ndaj tre institucioneve, ndaj Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Tiranë dhe Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, për shkakun se në fushatën për zgjedhjet vendore të datës 14

maj 2023, kanë zhvilluar takim në një ambient kulturor që është në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe që është përdorur në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore në fuqi (denoncimi nr. 409 ID).

2. Denoncuesi ka identifikuar si shkelje konkrete në tekstin e denoncimit, protokolluar në KQZ me nr. 4896, datë 10.05.2023, shkeljen e detyrimit për raportimin e veprimtarive publike nga institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, sikurse parashikon pika 1 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe faktin se veprimtaria e zhvilluar përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të shkronjës “c” të pikës 1.1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020. Në përfundim të hetimit administrativ, denoncuesi ka identifikuar si shkelje përdorimin e kundërligjshëm të aseteve publike gjatë fushatës zgjedhore dhe ka kërkuar *“sanksionimin e kandidatit për kryetar bashkie për shkeljen e kryer dhe të zonjës Margariti si person zyrtar që ka marrë pjesë në kryerjen e shkeljes, si dhe të drejtorit të TKOBAP që ka lejuar shfrytëzimin e burimeve dhe aseteve publike”*.
3. Neni 77 i K.Pr.Administrative e vendos organin që kryen një hetim administrativ përpara detyrimit që të hetojë kryesisht të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Organi publik përcakton në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes (pikat 1 dhe 2 të nenit 77 të K.Pr.Administrative). Thelbi i detyrimit të hetimit kryesisht konsiston në kërkesën që organi publik nuk mund të kufizohet në informacionet dhe provat e servirura nga palët. Ai duhet të kërkojë çdo informacion dhe të mbledhë çdo provë që nevojitet për marrjen e një vendimi përfundimtar të ligjshëm. Detyrimi zbatohet si për procedurat kryesisht, ashtu dhe për procedurat e filluara me kërkesë¹.
4. Hetimi administrativ i Komisionerit nuk i ka dhënë përgjigje pyetjes se kur është zhvilluar veprimtaria e denoncuar, fakt ky i mbështetur edhe nga kërkesa përfundimtare e përfaqësuesit të administratës së KQZ-së gjatë shqyrtimit administrativ në KAS të kësaj kërkesë, i cili i qëndroi kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, por duke ndryshuar datën e aktivitetit nga data 4 maj 2023 në datën 3 maj 2023. Nga ana tjetër, Komisioneri ka identifikuar Ministrinë e Kulturës

¹ Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nga SIGMA - Tiranë 2018, faqe 354

si institucion organizator, bazuar vetëm në dy pohime të përfaqësueseve të TKOBAP-së, në pohimin se pamjet video tregojnë mjediset e hollit të TKOBAP-së dhe në pohimin evaziv se “*ne jemi institucion varësie i Ministrisë së Kulturës dhe për çdo aktivitet që Ministria e Kulturës mund të kërkojë hollet ose ambientet e teatrit, ata e kanë të drejtën e tyre të vijnë dhe të zhvillojnë konferenca, aktivitete...*”.

5. Identifikimi i datës së zhvillimit të veprimtarisë ka rëndësi për hetimin administrativ, sepse veprimtari të caktuara publike konsiderohen në shkelje të K.Zgjedhor vetëm nëse zhvillohen pas një date të caktuar. Dosja e çështjes përmban dy prova të padiskutueshme që përqasin datën e zhvillimit të veprimtarisë:

- postimin në platformën “Facebook” nga Elva Margariti

<https://www.facebook.com/MargaritiElva/posts/pfbid02dVLëjs3së2o4xn5s1GZ62hPbBCHdD3Q9jHGBtRb4AKw3yQehdBDMCUtRLroaBZuyI>

“Bashkë me Erionin kaluam një moment ndryshe me miqtë tanë artistë, ata që na frymëzojnë dhe na mbushin shpirtin me artin e tyre; por që përtej skenës ndajnë me ne të njëjtat ptoblematika.

Në këto vite jemi përballur me sfida e vështirësi, por po përpiqemi të luftojmë me kohën për t'u rikthyer institucioneve kulturore dinjitetin që meritojnë; që nga përmirësimi i infrastrukturës, te rritja e pagave.

Kemi ende rrugë të gjatë përpara dhe do ta përshkojmë së bashku!

Falenderime për çdonjërin prej tyre, për sakrificat në emër të artit!

Postimi me foto është i datës 3 maj 2023, ora 21:35.

- Postimin në platformën “Facebook” nga Elva Margariti

<https://www.facebook.com/MargaritiElva/videos/954092469346851/>

Shumë i lumtur që u takova dhe bisedova me shumë miq të mirë artistë, njerëz të nderuar të qytetit tonë, me të cilët folëm edhe për disa ide konkrete që duam të bëjmë për artin dhe kulturën, duke nisur me rikthimin e Bienales së Tiranës.

Postimi me video është i datës 4 maj 2023, ora 16:30.

Denoncuesi ka pretenduar se veprimtaria është zhvilluar në datën 4 maj 2023, ora 16:30, bazuar në datën dhe orën e postimit të videos së takimit. Prova e parë e servirur prej tij, postimi i fotove nga takimi, përjashton mundësinë që takimi të jetë zhvilluar në datën 4 maj 2023. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e TKOBAP-së kanë pasur detyrimin ligjor që të referonin datën e saktë të zhvillimit të veprimtarisë, bazuar në nenin 137 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit *“KQZ-ja u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ”*. Komisioneri nuk e ka kërkuar këtë dhe ata nuk e kanë bërë, por bashkarisht kanë harxhuar kohë dhe energji për të saktësuar një të dhënë të padobishme për hetimin administrativ, atë të identifikimit të veprimtarive që janë zhvilluar në këtë institucion në datën 4 maj 2023.

6. Nga analiza e fakteve dhe e qëndrimit të palëve në proces, KAS-i krijon bindjen se data e zhvillimit të veprimtarisë ka qenë data 3 maj 2023, kjo e vërtetuar nëpërmjet ftesës së vetë kryetarit të Bashkisë Tiranë, njëkohësisht edhe kandidat për kryetar për Bashkinë Tiranë për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 si dhe nëpërmjet postimeve në llogaritë në rrjete sociale Facebook dhe Instagram të Ministres së Kulturës Elva Margariti. Kjo datë është brenda afatit katër mujor, gjatë të cilit vepron detyrimi për raportim për veprimtaritë publike të institucioneve dhe brenda afatit 30 ditor të fushatës zgjedhore, gjatë të cilit vepron ndalimi për vënien në dispozicion të asteteve të organeve apo enteve publike, për qëllime zgjedhore.
7. Nga shqyrtimi i provës video rezulton se Ministria e Kulturës e ka filluar fjalën e saj me shprehjen *“Shumë faleminderit që na u bashkuat në këtë ftesën time dhe të Erionit...”*. Ministria Margariti është vetdeklaruar bashkëorganizatore e takimit. Komisioneri nuk ka pasur asnjë provë në dispozicion që të kundërshtonte qenien e zonjës Elva Margarit dhe të zotit Erion Veliaj bashkëorganizatorë të kësaj veprimtarie. Deklarimi i zonjës Margariti si bashkëorganizatore me zotin Veliaj, siç del qartë nga shqyrtimi i provës, është bërë në praninë e vetë zotit Veliaj, i cili ka

marrë fjalën fill pas zonjës Margariti dhe nuk e ka kundërshtuar pozicionimin e tij si bashkëorganizator. **Këto rrethana e bëjnë të pashpjegueshëm mospërfshirjen e kandidatit për kryetar të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, nga përgjegjësia e bashkëorganizimit, që ka bërë Komisioneri në përfundim të hetimit.**

8. Zonja Margariti dhe zoti Veliaj janë persona që gëzojnë cilësi të dy ose shumëfishtë, funksionare të lartë të Partisë Socialiste, ministre dhe kryetar bashkie (titullarë institucionesh) dhe, për zotin Veliaj, kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Hetimi administrativ duhet të identifikonte qartë dhe, pavarësisht pretendimeve të palëve, statusin me të cilin secili prej tyre merrte pjesë në këtë veprimtari, gjë që mund të bëhet vetëm nëse analizohet drejt dhe saktë veprimtaria, sjellja e protagonistëve në të dhe konteksti i përgjithshëm provues.
9. Pamjet video tregojnë pjesëmarrje individuale të të dy protagonistëve në veprimtari (mungon çdo indikacion për shoqërimin e tyre nga stafet respektive). Mjedisi ku është zhvilluar veprimtaria është i zhveshur nga çdo dekor, sidomos nga çdo dekor me referenca institucionale. Postimi në platformën “Facebook” është bërë nga llogaria personale e zonjës Margariti dhe jo nga llogaria e institucionit. Nuk rezulton që takimi të ketë pasur temë të dedikuar, të lidhur me institucionet respektive. Të gjitha këto rrethana shkojnë në favor të tezës se si Ministrja e Kulturës, ashtu dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë nuk kanë marrë pjesë në veprimtari në cilësinë e tyre si titullarë institucionesh. Në të njëjtën mënyrë mungojnë të dhënat që do ta lidhnin takimin me Partinë Socialiste dhe funksionet e protagonistëve si përfaqësues dhe zyrtarë të lartë të kësaj partie (mungojnë logo apo shenja të tjera dalluese të PS-së, mungon prezenca e dinjitarëve politikë, stafit apo mbështetësve të kësaj partie, mungon tematika partiake).
10. **Shqyrtimi dhe analiza e provës video provon jashtë çdo dyshimi, se veprimtaria është veprimtari zgjedhore dhe lidhet vetëm me cilësinë e zotit Veliaj si kandidat për kryetar bashkie i bashkisë Tiranë. Veprimtaria duket se nuk synon të bindë pjesëmarrësit që të mbështesin kandidaturën e zotit Veliaj (protagonistët nuk kërkojnë votën e pjesëmarrësve në takim), ndonëse ky motiv nuk mund të përjashtohet, por më tepër synon të përcjellë mesazhin tek publiku, se artistët dhe krijuesit janë me kandidatin Veliaj, marrin pjesë me të, e çmojnë,**

mbështesin politikat e tij dhe përkrahin kandidaturën. Qëllimi elektor zbulohet së paku nga këto rrethana:

- si zonja Margariti, ashtu dhe zoti Veliaj në fjalën e tyre i referohen fushatës zgjedhore dhe veprimtarinë e vendosin në kontekstin e fushatës. *“E dimë që fushata na sjell atë ritmin për t’u takuar me sa më shumë njerëz, por nuk ka asnjë gjë të keqe fakti që jemi në fushatë dhe jemi pikërisht për të dëgjuar edhe ankesat edhe kritika edhe fjalët e mira ...”* thotë zonja Margariti në hyrje të fjalës së saj, kurse zoti Veliaj e nis fjalën e tij me shprehjen *“... doja vërtet që të kishim këtë “pit-stop”. Kjo fushata është pak e rrëmujshme, me stacione pafund, por doja të kisha tamam një “pit-stop”, një ndalesë të vogël, ku njeriu ndërron gomat, ndërron vajin, filtrat, pra rigjeneron makinerinë me të cilën ecën përpara, kryesisht për t’ju thënë faleminderit për këtë rrugëtim që ka qenë një rrugëtim i jashtëzakonshëm për mua ...”*;
- audienca e përzgjedhur për takimin i shërben zgjedhjeve në funksion të dyfishtë, si elektorat i qëmtuar dhe elitar, tek të cilët përcillet mesazhi i posaçëm për arritjet dhe zotimet në fushën e kulturës, por edhe duke sugjeruar për publikun, nëpërmjet imazheve, “lidhje” apo përafëri midis kandidatit Veliaj dhe figurave publike të fushës së artit, jo të gjithë domosdoshmërisht mbështetës të tij;
- të dy protagonistët promovojnë arritjet qeverisë dhe shpalojnë projektet e së ardhmes (tematikë elektorale *par excellence*);
- zonja Margariti lartëson vlerat e posaçme të kandidatit Veliaj dhe meritat e tij të veçanta në lehtësimin e bashkëpunimit qeveri-pushtet vendor në fushën e kulturës.

11. Kjo analizë e rrethanave dhe fakteve të çështjes çon në përfundimin, se konstatimi i Komisionerit se ngjarja e denoncuar përbën veprimtari publike të Ministrisë së Kulturës, për të cilën ministria ka pasur detyrimin për raportim nuk është i mbështetur dhe nuk mund të konsiderohet nga KAS-i si përfundim i ligjshëm i hetimit administrativ. Përfundimi i vetëm i ligjshëm i hetimit do ishte klasifikimi i veprimtarisë si veprimtari elektorale e kandidatit për

kryetar të bashkisë Tiranë Erion Veliaj për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, me pjesëmarrjen e posaçme dhe aktive të zonjës Elva Margariti, si dinjitare.

12. Duke u referuar tek arsyetimi i sipërcituar në lidhje me natyrën e aktivitetit – veprimtari elektorale – nuk mund të konsiderohet shkelje mosraportimi i kësaj veprimtarie nga personi përgjegjës pranë Ministrisë së Kulturës, siç ka pretenduar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi veprimtaritë elektorale të subjekteve zgjedhore nuk mund/duhet të raportohen nga institucionet publike. Për këtë arsye, kërkesa e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për të sanskionuar me dënim administrativ me gjobë Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Kulturës, në cilësinë e personit përgjegjës për raportimet e veprimtarive publike, është e pabazuar në ligj dhe në prova, ndaj duhet të rrëzohet.
13. Veprimtaria elektorale e kandidatit Erion Veliaj është zhvilluar në mjediset e një enti publik, në hollin e TKOBAP-së. Hetimi administrativ i Komisionerit nuk ishte thelluar dhe KAS-i nuk mund të provonte në kushtet e seancës për shqyrtimin e kërkesës, nëse kuarteti i harqeve që argëtonte pjesëmarrësit ishte pjesë e TKOBAP-së, apo jo. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për impiantin e zërit (foninë) të përdorur në këtë veprimtari. Në këto kushte mbetet konstatimi i përdorimit të burimeve dhe asetëve publike vetëm sa i takon mjediseve ku u zhvillua veprimtaria. Ky përdorim vjen në kundërshtim me pikën 1 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Përgjegjësia për këtë shkelje i takon drejtores së Përgjithshme të TKOBAP-së, zonjës Abigeila Voshtina, ndaj së cilës duhet të merret masë administrative, sipas pikës 2 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, e cila përcakton se *“shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë”*.
14. **Zoti Erion Veliaj ka marrë pjesë në veprimtarinë e denoncuar në cilësinë e tij si kandidat për kryetar bashkie për bashkinë Tiranë, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të nenit 2 përcakton se *“subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe KANDIDATËT PËR KRYETARË TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE, të regjistruar në përputhje me këtë Kod*”**. Kjo do të thotë, se në trajtimin e shkeljes së konstatuar, Komisioneri ka qenë i detyruar ta trajtonte kandidatin në cilësinë e tij si **SUBJEKT ZGJEDHOR**.

15. Pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se *“subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”*. Kandidati për kryetar bashkie, z. Veliq ka qenë në dijeni të zhvillimit të veprimtarisë në mjediset e një enti publik (bashkorganizator, sipas ministres Margariti). Sidoqë të kenë qenë rrethanat e organizimit, si subjekt zgjedhor ai ka patur detyrimin për ndërprerjen e menjëhershme të shkeljes, gjë që nuk ka ndodhur. Në kushtet kur ai ka qenë në cilësinë e subjektit zgjedhor si kandidat për kryetar bashkie i Bashkisë Tiranë në këtë aktivitet, është e qartë se aktiviteti është në shkelje të ndalimeve të parashikuara në Kodin Zgjedhor, aktivitet ky që është kryer në favor të tij.
16. KAS-i ka vendosur sanksione ndaj kandidatëve për kryetar bashkie në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, në një numër të konsiderueshëm rastesh (shih vendimet e KAS-it nr. 84, datë 08.05.2023, nr. 85, datë 08.05.2023, nr. 87, datë 10.05.2023). Në të gjitha rastet, masa e dënimit me gjobë është përcaktuar në minimumin ligjor. **Në çështjen e denoncimit nr. 409 ID, KAS-i çmon se duhet të vlerësohen në mënyrë të posaçme rrethanat që kanë lidhje me keqpërdorimin e aseteve të një institucioni të rëndësishëm të kulturës kombëtare dhe me impaktin e shtuar që është synuar të krijohet në elektorat nëpërmjet kësaj veprimtarie. Mjediset e TKOBAP-së janë mjedise familjare për artistët, janë “shtëpia e tyre”, element ky që e bën më të lehtë tundimin për të marrë pjesë në këtë veprimtari, pavarësisht bindjeve politike. Nga ana tjetër, mbledhja rreth një kandidati, në mjediset e një institucioni kombëtar të artit, i një numri të madh personalitetesh të fushës, tërheq vëmendje më të madhe në publik. Reputacioni publik i artistëve shtrihet përtej audiencës tipike elektorale. Prandaj impakti elektoral i veprimtarisë është më i lartë, sikurse është më i lartë avantazhi i ardhur nga keqpërdorimi i aseteve publike. Sipas shkronjës “f” të pikës 2 të nenit 172, KAS-i ka detyrimin që të mbajë në konsideratë këtë impakt kur të caktojë masën e gjobës, e cila duhet të jetë më e lartë se minimumi ligjor që është preferuar të aplikohet në fazën fillestare të zbatimit të dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor.**
17. KAS-i çmon se nuk ka vend për aplikimin e sanksioneve ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” që mbështeste në zgjedhje kandidatin Veliq. Gjatë shqyrtimit të kërkesës në KAS,

si përfaqësuesit e administratës, po ashtu dhe ata të palës së interesuar nuk sollën prova për të vërtetuar faktin nëse Partia Socialiste e Shqipërisë ka qenë apo jo në dijeni të zhvillimit të këtyre aktiviteteve në kushtet e ndalimit nga Kodi Zgjedhor, ose që personalitete drejtuese të saj të kenë marrë pjesë në këto veprimtari. Në këtë vlerësim KAS-i merr në konsideratë edhe faktin se Ministria e Kulturës dhe kandidati për kryetar bashkie nuk i janë drejtuar asnjëherë audiencës në emër të Partisë Socialiste, pavarësisht faktit se z. Erion Veliaj ka qenë njëkohësisht edhe drejtues i fushatës zgjedhore për këtë subjekt zgjedhor për të gjithë qarkun e Tiranës, por duket qartë nga fjala e tij në këtë aktivitet se ky i fundit është organizuar vetëm për interesin e tij si kandidat dhe jo atë të Partisë Socialiste në nivel qarku.

18. Nga pozicioni i saj zyrtar, zj. Margariti ka patur detyrimin, sipas pikës 2, të nenit 3, të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, që të mos merrte pjesë dhe të mos kontribuonte në çfarëdolloj forme në këto veprimtari, për shkak se veprimtarisë i ishin vënë në dispozicion asete (holli i TKOBAP-së), në pronësi/administrim të një institucioni publik, për qëllime zgjedhore. Ushtrimi i funksionit të ministrit nuk është në konflikt me pjesëmarrjen në fushatë zgjedhor, por ministri, si titullar institucioni publik, ka detyrimin që të respektojë kufizimin që i ndalon atij, në cilësinë si titullar i institucionit ku më konkretisht sipas vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, parashikohet se *“të drejtojë, të marrë pjesë apo të kontribuojë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara”*.
19. Sikurse KAS-i ka shtjelluar edhe në vendime të mëparshme, pika 2 e nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, është dispozitë ndaluese që është vendosur rishtazi me vendimin e Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, por nuk ka referencë korresponduese në ndonjërin nga dispozitat sanksionuese të Kodit Zgjedhor. Funkionarët e listuar në pikën 2 të nenit 3 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020, nuk bëjnë pjesë në listën e *“personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodit”*. Sanksioni për ta nuk mund të vendoset sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Në konkurrimin midis dispozitës së pikës 2 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor dhe dispozitës së pikës 2 të nenit 10 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, KAS-i ka pranuar edhe më parë (shih vendimet nr. 45, datë 04.04.2023, nr. 56, datë 11.04.2023 dhe nr. 65, datë 24.04.2023) zbatueshmërinë e dispozitës që vjen nga ligji dhe jo të dispozitës që vjen nga akti nënligjor i Komisionit Rregullator.

20. Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", në nenin 6 të tij, ka vendosur kufij të cilët nuk lejojnë që shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikohen me akte nënligjore, sikurse ka përcaktuar në nenin 10 se, "*masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative*". Autorizimi i pikës 5 të nenit 91 të Kodi Zgjedhor, sipas të cilit "*KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike*", nuk mund të përfshijë të drejtën e Komisionit Rregullator për të caktuar me akt nënligjor dënime administrativ me gjobë, në kundërshtim me formulimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Për rrjedhojë dispozita e aplikueshme për sanksionim në rastin e zj. Elva Margariti mbetet ajo e pikës 2 të nenit 171.
21. Në lidhje me të drejtën e ankimit, sa i përket z. Erion Veliaj, duke qenë se ai është dënuar administrativisht në cilësinë e subjektit zgjedhor, në zbatim të nenit 145 pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se "*Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi*", ai mund ta ushtrojë të drejtën e ankimit pikërisht duke ju drejtuar Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Duke qenë se ky vendim është marrë jashtë periudhës e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit për zgjedhje, atëherë ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Ky qëndrim mbështetet dhe në praktikën e Kolegjit Zgjedhor që e ka pranuar kompetencën për shqyrtimin e dënimeve administrative ndaj subjekteve zgjedhore, më konkretisht në vendimin nr. 3, datë 09.03.2023.
22. Në lidhje me të drejtën e ankimit për subjektet e tjera, znj. Elva Margariti dhe znj. Abigeila Voshtina, duke qenë se nuk janë në cilësinë e subjekteve zgjedhore, ajo mund të ushtrohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21 pika 1 shkronja 'dh', si dhe në nenin 172 pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit dhe pranimin e pjeshëm të kërkesave të palës së interesuar Orgaizata “Drejtësia Sociale”;
2. Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, sipas nenit 172 pika 1 të Kodit Zgjedhor, në masën 155 000 (njëqind e pesëdhjetë e pesëmijë) lekë;
3. Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë ndaj znj. Elva Margariti dhe znj. Abigeila Voshtina, sipas nenit 171 pika 2 të Kodit Zgjedhor, në masën 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë;
4. Pushimin e hetimit administrativ për znj. Zerina Bruçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Kulturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për pikën 2 të dispozitivit, bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 30 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 152 të tij.

Për pikën 3 të dispozitivit, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

U shpall sot, më datë 13.11.2023.

Ledio	BRAHO	-	Relator	
Elvin	LAKO	-	Anëtar	(Kundër)
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar	
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar	